



Funded by
the European Union



QKRMT-KRCT

Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës
The Kosova Rehabilitation
Center for Torture Victims



**RRUGËT DREJT DREJTËSISË:
PERSPEKTIVA E NJË TË MBIJETUARE DHE
PËRPJEKJET PËR TË ADRESUAR DHUNËN
SEKSUALE GJATË KONFLIKTIT NË KOSOVË**

- Rast studimor -

Autorë: QKRMT

Ky rast studimor është bërë nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), si pjesë e projektit 4CRSV Survivors - “*Rrugët drejt fuqizimit: Promovimi i drejtësisë, shërimit dhe gjithëpërfshirjes për të mbijetuarit e dhunës seksuale lidhur me konfliktin*”. Megjithëse organizata përmendet disa herë në përmbajtje dhe subjekti është klient në organizatë, studimi i përmbahet një analize rigoroze, duke shmangur ndikimin e kësaj lidhje. Studimi, përfundimet dhe rekomandimet e paraqitura bazohen në këtë analizë rigoroze, dhe janë pasqyrim vetëm i përkushtimit për të adresuar dhunën seksuale lidhur me konfliktin.

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e botimit është përgjegjësi vetëm e KRCT dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

© E drejta e autorit është e rezervuar nga QKRMT. Ndalohet kopjimi, riprodhimi, publikimi i paautorizuar, qoftë original apo i modifikuar në çfarëdo mënyre pa lejen me shkrim të QKRMT-së.



ABSTRAKTI

Të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë [1998-1999], përveç përjetimit të një tragjedie jetëndryshuese, janë ballafaquar me një kontekst social të definuar nga stigma dhe me mungesë të drejtësisë. Ky rast studimor ka për qëllim të nxjerrë në dritë perspektivën e drejtpërdrejtë të një të mbijetuarë në lidhje me drejtësinë, si dhe për të nxjerrë në pah procesin aktual të vënies së drejtësisë, duke analizuar sfidat, strategjitë dhe zgjidhjet deri më tani. Përmbajtja e rastit studimor bazohet në intervistë me një të mbijetuar të dhunës seksuale. Si konkluzion, rasti studimor adreson boshllëqet në kuadrin ligjor, sugjerimet se çka do të ndihmonte këtë fushë, si dhe si duket e ardhmja sa i përket drejtësisë për të mbijetuarit e dhunës seksuale në Kosovë.

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	5
Stigma dhe pasojat	5
Drejtësia për të mbijetuarit	6
METODOLOGJIA	7
GJETJET NGA INTERVISTA	8
Konteksti i drejtësisë pas konfliktit sipas perspektivës së të mbijetuarës	9
Ndikimi i stigmës në drejtësi	9
Ngjarjet inkurajuese dhe dekurajuese	10
Rëndësia e drejtësisë për të mbijetuarën	11
Si do të mund të ndihmonin të tjerët?	12
Pritshmëritë në aspektin e drejtësisë	13
ANALIZË	14
Qasja në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit	14
Njohja ligjore e viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit dhe procesi i aplikimit ...	15
KONKLuzionET	17
REKOMANDIME	19
REFERENCAT	21

HYRJE

Konteksti i pas-konfliktit

Lufta e viteve 1998-1999 në Kosovë ka pasur dëme të mëdha njerëzore. 13,317 njerëz civilë janë vrarë gjatë kësaj periudhe, 800,000 janë zhvendosur si refugjatë, ndërsa mbi 1600 persona mbesin [në kohën e shkrimit të këtij studimi] akoma të zhdukur, duke lënë një hapësirë të madhe në shërimin e një gjenerate, por duke afektuar edhe tjerat. Njëra nga format e krimeve gjatë konfliktit në Kosovë ka qenë dhunimi seksual. Besohet se më shumë se 20,000 njerëz, kryesisht gra, kanë qenë viktime¹ të dhunës seksuale brenda periudhës gusht 1998 - gusht 1999 [Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës [QKRMT], 2021, fq. 18]. Efektet negative të traumës nga këto dhunime janë përcjellur edhe tek gjenerata tjetër. Këto efekte kanë lënë gjurmë edhe në epigjenetikën e fëmijëve të viktimave të lindur pas konfliktit [Hjort et al., 2021].

Përtej statistikave, këta persona mbajnë barrën e rëndë të të qenurit viktime të një mjeti të konfliktit, që dallon në një mënyrë specifike nga të tjerët: shënjestrimi primar i përdhunimit gjatë konfliktit është të shkaktojë traumë dhe të shkatërrojë lidhjet familjare dhe solidarizimin e anëtarëve tjerë të popullsisë me viktimën [Diken dhe Lausten, 2005a]. Studimet që kanë analizuar përdorimin e dhunimit në vende me konflikte të armatosura, theksojnë se mesazhi i brendshëm që kryesi ka për qëllim të përcjellë, është që burrat nga popullsia kundërshtarë nuk mund të mbrojnë gratë e veta [Danjibo dhe Akinkuotu, 2019]. Në Kosovë, në 70% të rasteve familjarët kanë qenë dëshmitarë të dhunimit [QKRMT, 2021, fq. 15].

Stigma dhe pasojat

Ndonëse si mjet konflikti përdhunimi është ofenzivë ndaj komunitetit kundërshtar si kolektiv, viktimat në Kosovë janë ndjerë të izoluara dhe bartëse individuale të kësaj mizorie. Kjo në pjesën më të madhe për shkak të stigmës. Për shembull, gratë e dhunuara që nuk ishin të martuara në kohën e dhunimit kanë pasur frikë që nuk do të martohen dhe të kenë jetë familjare nëse e zbulojnë çfarë u ka ndodhur, ndërsa të tjerat janë frikësuar që do të divorcohen dhe përjashtohen. Fatkeqësisht, kjo frikë nuk ishte e pabazuar. Një shkrim hulumtues i vitit 1999 i citon burrat nga intervistat e drejtpërdrejta që thonë se do të divorcoheshin me gratë e veta nëse do të kuptonin se janë dhunuar seksualisht [Bumiller, 1999].

Human Rights Watch, që është organizatë ndërkombëtare për hulumtim dhe avokim mbi të drejtat e njeriut, ka hulumtuar – mes tjerash – ushtrimin e dhunimit dhe formave tjera të dhunës seksuale gjatë viteve 1998 dhe 1999 duke bërë intervista gjatë kësaj kohe. Ata kanë arritur në konkluzionin se dhunimet në Kosovë janë bërë si mjet i konfliktit për spastrim etnik dhe nuk janë bërë sporadikisht nga individë [Human Rights Watch, 2001].

1 Në këtë rast studimor përdoren të dy termet, *viktimë* dhe *i/e mbijetuar*. Termi *viktimë* përdoret për të indikuar që personat kanë qenë viktime të një krimi dhe i referohet aktit të dhunës. Termi *i/e mbijetuar* përdoret për të theksuar fuqinë dhe reziliencën e personit.

Megjithatë, edhe ata kanë theksuar se stigma kulturore i ka komplikuar në mënyrë të ndjeshme përpjekjet për dokumentim. Ndonëse kanë besuar që rastet e dokumentuara nga ta [96] përfaqësojnë vetëm një fraksion të incidenteve të dhunës seksuale, dokumentimi ishte i kufizuar si shkak i turpërimit që e ndjenin viktimat, dhe pasojave që mund të kishin.

Në vitin 1999 filloi punën Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve (QKRMT)², njëra nga organizatat e para e cila punon me të mbijetuar të torturës dhe dhunës seksuale nga konflikti. Fushëveprimtaria e saj përfshin ndihmën për të mbijetuarit që të ballafaqohen me traumën, si dhe kontributin në zhvillimin e një sistemi institucional të mbështetjes, adresimit dhe llogaridhënies. Nga QKRMT raportohet për një numër të madh sidomos të grave të cilat vazhdojnë të jetojnë duke mos e bërë të njohur as tek famijarët e tyre ngjarjen e dhunimit. Pavarësisht që dihet që në Kosovë ka pasur dhunime, viktimat janë përgjithësisht të heshtura, duke u ndjerë më të pranuar në shoqëri nëse përjetimi i tyre nuk është i ditur.

Në vitin 2018, 19 vjet pas përfundimit të konfliktit, me mbështetjen e QKRMT-së, Vasfije Krasniqi-Goodman ka dalur publikisht si e mbijetuar e dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë. Kjo dalje ka shënuar arritje dhe kthesë për të mbijetuarit, por edhe për shoqërinë kosovare në përgjithësi. Një vit më vonë, edhe një e mbijetuar tjetër, Shyhrete Tahiri-Sylejmani ka thyer publikisht heshtjen, me qëllimin kryesor për të kërkuar drejtësi dhe për solidaritet me të mbijetuarat tjera. Sot ato avokojnë për drejtësi në platforma lokale dhe ndërkombëtare.

Drejtësia për të mbijetuarit

Kërkimi i drejtësisë për viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit së viteve 1998-1999 në Kosovë, është përpjekje shumëdrejtimëshe. Ajo përfshin aspekte ligjore, sociale dhe psikologjike. Duke pasur parasysh pasojat e shumta të konfliktit [të adresuara në seksionet e para], duhet theksuar se ato kanë lënë plagë të thella tek individët dhe populli kosovar si tërësi.

Prandaj udhëtimi drejt drejtësisë përfshin jo vetëm ndjekjen penale të autorëve, por edhe sigurinë që të mbijetuarit të marrin mbështetjen e nevojshme për të rindërtuar jetën e tyre, përfshirë qasjen në ndihmë juridike, si dhe ndihmë psikologjike gjatë proceseve ligjore.

Organizatrat e shoqërisë civile, në veçanti QKRMT, si dhe institucionet kompetente kanë bashkëpunuar për të krijuar një mjedis mbështetës që promovon drejtësinë dhe rikuperimin. Përpjekjet e tyre kanë çuar në arritje të rëndësishme, ndonëse sfidat kanë qenë të shumta.

2 OJQ e themeluar në vitin 1999. Më shumë informacione gjinden në webfaqen <https://krct.org/>.

Adresimi i akteve të tmerrshme gjatë konfliktit në Kosovë ka pasur të bëjë edhe me institucionet ndërkombëtare edhe vendore. Në ndërkohë janë bërë ndryshime ligjore që synojnë të ofrojnë mbështetje për të mbijetuarit.

Megjithëse është bërë përparim, rruga drejt drejtësisë mbetet e ndërlikuar, siç shtjellohet në seksionet e mëposhtme. Rasti studimor aktual, si qëllim dhe inovacion e ka perspektivën në lidhje me drejtësinë nga vet një person që ka qenë viktimë e dhunës seksuale gjatë konfliktit.

Rasti studimor prezent do të: 1) adresojë se si konteksti psikosocial dhe institucional në 25 vitet e fundit të paskonfliktit e kanë formësuar pozicionin e një të mbijetuarë të dhunës seksuale gjatë konfliktit në temën e drejtësisë, dhe 2) do të sqarojë procesin e kërkimit të drejtësisë, përkatësisht sfidat, strategjitë dhe zgjidhjet, duke u ndërlidhur me pikat kyçe nga intervista.

METODOLOGJIA

Për qëllimin e këtij rasti studimor, është bërë një intervistë e gjysëm-strukturuar me një të mbijetuar të dhunës seksuale gjatë konfliktit. E intervistuar është përfituese e shërbimeve në Qendrën Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës, ku ka marrë shërbime psikologjike si dhe ndihmë juridike lidhur me procedurat që duhet ndjekur për sjelljen e kryesve para drejtësisë. Kriteri për intervistë ka qenë që i/e intervistuari/ja të jetë i/e mbijetuar e dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë. Janë kontaktuar tre raste potenciale, dhe përzgjedhja e rastit specifik është bërë vetëm në bazën e vullnetit dhe disponueshmërisë.

Intervista është fokusuar në pyetje të tipit eksplorues rreth temës së drejtësisë, përkatësisht ka targetuar perspektivën dhe përvojën e të intervistuarës në këtë çështje. Pyetjet nuk kanë qenë të përqendruara në ngjarjen që ka ndodhur, përkatësisht të dhunimit. Materiali i nxjerrë nga intervista është selektuar mbi kriterin e temës në fokus, dhe informacionet nga intervista të përqendruara në temat tjera rreth dhunës seksuale janë përjashtuar. Intervista është zhvilluar një herë, me kohëzgjatje dy orë e gjysmë.

E intervistuar ka dhënë paraprakisht pëlqimin e saj të informuar në lidhje me intervistën dhe publikimin e gjetjeve të saj për këtë rast studimor. Publikimi i përmbahet të gjitha rregullave të anonimitetit, dhe çdo informacion identifikues rreth të intervistuarës është përjashtuar në materialin e nxjerrë nga intervista.



GJETJET NGA INTERVISTA

E mbijetuara është grua 50 vjeçare, e martuar, dhe ka tre fëmijë. Gjatë kohës së konfliktit, përkatësisht kur ka ndodhur dhuna seksuale, ishte 24 vjeçare. Në rastin e të intervistuarës, mënyra e dhunës seksuale ka qenë dhunimi, sikurse në 99% të rasteve të dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë [QKRMT, 2021, fq. 16].

Në aspektin e arsimit dhe të profesionit, e intervistuarja ka ndjekur shkollën fillore, dhe nuk ka arsim formal të mëtutjeshëm, si dhe është e papunësuar. E intervistuarja ka ndjekur disa kurse të aftësimit profesional pas konfliktit (rrobaqepësi, aftësi kompjuterike), kryesisht të ofruara nga organizata të ndryshme humanitare. E intervistuarja thotë se në kohën e ngjarjes ka qenë një 24 vjeçare plot jetë, por pastaj edhe aspiratat e saj për jetën kanë ndryshuar negativisht dhe tani nuk ka motiv të realizojë qëllimet e saj paraprake, sidomos socio-ekonomike.

Shëndeti i saj është më i mirë sesa në vitet e para të paskonfliktit, por pasojat në shëndetin mendor janë akoma të theksueshme. Ajo përdor vazhdimisht medikamente anti-depresive për të rregulluar gjendjen emocionale, si dhe raporton probleme me gjumin.

Në QKRMT aktualisht merr shërbime mjekësore dhe psikologjike, si dhe ka marrë pjesë në aktivitete për informimin mbi procesin ligjor të ndjekjes penale ndaj kryesve.

Konteksti i drejtësisë pas konfliktit sipas perspektivës së të mbijetuarës

Stigmatizimi i dhunimeve të lidhura me konfliktin, siç është e pritshme, ka pasur impakt negativ në jetën e të mbijetuarës. Në vitet e paskonfliktit, ajo ka perceptuar një lloj boshllëku apo hapësire si rezultat i të mosfolurit mbi këtë çështje. Ky boshllëk ka bërë që ta brendësojë emocionin e turpfit, dhe idenë se viktimat e dhunës seksuale thjesht nuk kanë pasur vend në shoqërinë kosovare. Ajo gjithmonë është ndjerë si pjesë e një kategorie të izoluar, përjetimet e së cilës i konsideron më të rënda edhe se vrasja. Kjo e jehon, fatkeqësisht, atë që thonë edhe gratë tjera kosovare që kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë konfliktit.

Për të, gratë e dhunuara kanë qenë të pambrojtura, që e sheh edhe si qëllim të dhunuesve, për t'i turpëruar shqiptarët. E intervistuarja e percepton ngjarjen si 'shkatërrim total' në atë kohë, dhe 'një varrë që nuk mbyllet kurrë' nëse nuk ka drejtësi.

Në kohën e paskonfliktit, e intervistuarja është ndjerë e vetmuar sa herë që ka dëgjuar seanca parlamentare duke diskutuar çështjen e kategorive tjera të konfliktit e duke mos e përmendur kategorinë e viktimave të dhunës seksuale. Gjithashtu ajo mendon se institucionet e Kosovës nuk kanë punuar sa duhet për drejtësinë për këtë kategori dhe ndëshkueshmërinë e kryesve.

Në kushte normale, të mbijetuarit e dhunës seksuale kanë nevojë të shprehin barrën e asaj që ka ndodhur, në një hapësirë të sigurtë. Në rrethanat e një shoqërie konservative të paskonfliktit, nuk kanë mundur ta bëjnë këtë. E intervistuarja shpreh se ka qenë e bllokuar mes dy dinamikave: në njërin anë ka pasur nevojën për t'u shprehur dhe të kërkojë drejtësi, dhe në anën tjetër frikë për t'u përjashtuar nga familja dhe rrethi. Në përgjithësi, e intervistuarja beson se ka shumë të pathëna rreth dhunimeve gjatë konfliktit.

Pas konfliktit, kur KFOR (misioni i NATO-s në Kosovë) ka zhvilluar aktivitete mbështetëse në zonat ku ka jetuar e intervistuarja, ajo ka dashur t'u tregojë çfarë ka ndodhur, por në momentin e fundit është ndalur për shkak që vëllau i saj ka mundur të dëgjojë. Fakti që ka dashur t'ua thotë ndërkombëtarëve por duhet të heshte para familjes së vet, përfaqëson në mënyrë tipike kontekstin stigmatizues, rrjedhimisht edhe barrierat për të kërkuar drejtësi.

Ndikimi i stigmës në drejtësi

Stigma e përgjithshme, e indikuar edhe në seksionin e mësipërm, ka qenë pengesa më e madhe e të mbijetuarës. E intervistuarja thotë se të jetuarit me një ngjarje që ka qenë keqbërëse ndaj saj, por për të cilën prapë është ndjerë se duhet të turpërohet, i ka sjellur pasoja tejet negative. E mbijetuarja me bindje të plotë thotë se nëse të tjerët do të dinin çfarë ka ndodhur, do të përfundonte gjithçka, duke specifikuar se raportet familjare do të prisheshin.

Në momentin e intervistës, vetëm nëna dhe bashkëshorti i saj nga familjarët e dinë ngjarjen. Për t'i treguar bashkëshortit, i ishin dashur 19 vite, dhe atë pas fuqizimit nga seancat psikologjike në QKRMT. Edhe në rrethanat aktuale, bashkëshorti ofron ndihmë të kufizuar, duke mos e përkrahur shkuarjen e saj në seanca rehabilituese dhe në aktivitete informuese për ndihmë juridike.

Më herët ka hezituuar të aplikojë për njohje të statusit si viktimë e dhunës seksuale të konfliktit për shkak se ka menduar se emrat publikohen.

Në situatën aktuale, e mbijetuara mund të deponojë dëshminë e saj zyrtarisht për të kërkuar drejtësi, por nga frika e stigmatizimit, bashkëshorti i saj është kundër kësaj.

E vetmja gjë që ia ka lehtësuar vitet e paskonfliktit në kontekst të stigmës, ka qenë fakti që ajo nuk ishte e vetmja të përjetonte një ngjarje të tillë.

Ngjarjet inkurajuese dhe dekurajuese

Në vitin 2017, përmes rrjeteve sociale, e intervistuar kishte dëgjuar për QKRMT. Për tre vjetët e ardhshme e kishte konsideruar të kontaktonte, por nuk ndihej mjaftueshëm e fortë që, siç e shihte ajo, të ballafaqohej me të kaluarën. Në vitin 2020 kishte marrë kurajon dhe kishte kërkuar ndihmë. Ardhja e saj e parë ishte shoqëruar me ankth të madh. Pastaj, pas çdo here tjetër që kishte ardhur, tregon se është lehtësuar çdo herë e më shumë dhe ka ardhur me më shumë motiv. Ofrimi i ndihmës multidimensionale, si psikoterapia, vizitat mjekësore dhe medikamentet, si dhe vet përkatësia në një rreth mbështetës, e ka ndihmuar që të përjetojë fuqizim të panjohur më parë. Mbështetja dhe marrëdhënia e sigurtë dhe me terapisten e saj, e definuar nga empatia, ka qenë specifikisht një faktor ndryshues pozitiv.

Në vitin 2022 e ka marrë statusin si viktimë e dhunës seksuale gjatë konfliktit, përmes ligjit përkatës që i mundëson disa beneficione. Pensioni i përfituar nga ky proces ia ka lehtësuar pak situatën financiare, duke qenë se është e papunë. Megjithatë ka ndjenja të përziera rreth këtij pensioni, sepse nuk mund ta ndajë këtë ndihmë nga përvoja traumatike.

Në ndërkohë ka marrë pjesë edhe në takime grupore me gratë tjera, ku ka shkëmbyer mbështetje në një hapësirë të sigurtë. Kjo afërsi dhe siguri e ka ndihmuar që t'i përjetojë gjërat më lehtë. Takimet që e kanë pasur temë drejtësinë, e kanë bërë të ndihet që tash shihet si person, dhe është pjesë e shoqërisë. Motivi i saj i brendshëm gjithashtu i ka ndihmuar që të mos dorëzohet.

Dalja publike e Vasfije Krasniqi-Goodman ishte një pikë kthese edhe për të mbijetuarën. Të shikuarit e intervistës se Krasniqi-Goodman ishte shoqëruar me një shkarkim të madh emocional. Ndonëse e adreson edhe si nxitës (ang. trigger) të ngjarjes së saj traumatike të dhunimit, megjithatë kishte qenë inkurajim. E gjithë situata më pas i kishte vënë gjërat në lëvizje, duke ndikuar edhe ardhjen e saj në QKRMT.

Në vazhden e ngjarjeve inkurajuese, e intervistuarat thekson edhe takimin në QKRMT me të mbijetuarën (anonime për publikun) në rastin Vukotić³, si dhe me Shyhrete Tahiri-Sylejmani. Përfitimi emocional nga këto ngjarje si elemente të mbështetjes grupore, e kanë zvogëluar në mënyrë të konsiderueshme ndjenjën e saj të përjashtimit. Konkludimi i rastit të Vukotić me dënimin prej 13 vjet burg i ka dhënë shpresë për drejtësi. E intervistuarat shfaq admirim të madh për të mbijetuarat që kanë dalë publikisht, si dhe mirënjohje për personat që ju kanë ndihmuar në këtë rrugëtim.

Në anën tjetër, ngjarjet dekurajuese, sidomos konteksti i paskonfliktit, e kanë përcaktuar në pjesë të madhe perspektivën e të intervistuarës për drejtësi. Ajo tregon se për të luftuar për drejtësi, është e pamundur pa përkrahjen e familjes. E intervistuarat është dekurajuar shumë kur ka dëgjuar se burrat e disa grave janë shkurorëzuar me to pasi e kanë kuptuar se ato janë dhunuar gjatë konfliktit. Kjo e ka mbajtur të dëshpëruar dhe të rënduar, duke u frikësuar që të bisedojë edhe me bashkëshortin e saj.

Gjithashtu, mungesa në përgjithësi e drejtësisë dhe ndëshkueshmërisë gjer tani, si dhe mungesa e përgjegjshmërisë për adresimin e krimeve të dhunës seksuale në Kosovë gjatë konfliktit, kanë shkaktuar dëm tek e mbijetuarat. E intervistuarat raporton të jetë ndjerë e vetmuar dhe izoluar, duke çuar në tërheqje sociale. E gjitha kjo është përkeqësuar nga stigma sociale.

Rëndësia e drejtësisë për të mbijetuarën

Megjithë sfidat e mëdha në procesin e kërimit të drejtësisë deri tani, kjo mbetet një qëllim i të intervistuarës. E intervistuarat e konsideron vënien e drejtësisë si një ndër aspektet kyçe për mirëqenien e saj psikologjike. Deklarimi i saj se ‘shpirti rehatohet nëse e ballafaqoj dhunuesin, dhe kur të tjerët e dinë se ai është dhunues’, pasqyron rëndësinë personale që ka ky proces për të. Në përgjithësi, e intervistuarat thotë se vënia e drejtësisë është përkrahje morale për të dhe gjithë gratë e tjera që kanë përjetuar të njëjtën ngjarje. Duke iu referuar pjesëmarrjes në aktivitetet për qasje në drejtësi të organizuara nga QKRMT, e intervistuarat shprehet se tani ndihet se kjo kategori është diku (duke nënkuptuar progres), dhe se janë forcuar. Edhe pse bashkëshorti i saj nuk e përkrah që të dëshmojë për rastin e saj në organet e drejtësisë, por kjo nuk ia zbeh vendosmërinë që, brenda mundësive të saj, të jetë pjesë e proceseve që kanë të bëjnë me kërkimin e drejtësisë. E intervistuarat është e vendosur të vazhdojë si pjesë e programeve të QKRMT-së në lidhje me promovimin e drejtësisë. E intervistuarat shprehet në mënyrë të qartë që edhe nëse personalisht nuk e arrin drejtësinë me ndëshkimin e kryesve në rastin e saj, do të festojë me ata që e arrijnë drejtësinë në rastet e tjera.

Në lidhje me procesin gjyqësor, e intervistuarat konsideron që realizimi i këtij procesi do të ishte lehtësimi themelor, dhe se atëherë do të ndihej që po e merr një frymë lirshëm. E intervistuarat ndjen se pas dhunimit, i ishte dashur ‘ta riprodhojë’ vetën. Jeta e saj kishte ndryshuar plotësisht në aspektin psikosocial, prandaj nuk mund të vazhdonte në

3 Zoran Vukotić është i dënuari i parë dhe i vetëm deri tani për dhunimin si krim gjatë konfliktit.

të njëjtën mënyrë si më parë. E intervistuarat është e bindur se vënia e drejtësisë do t'i ndihmonte edhe më shumë profilit të saj si e mbijetuar. E intervistuarat shprehet fjalë për fjalë se po ta përkrahte familja, do ta depononte qysh tani dëshminë.

I gjithë procesi për të nënkupton një përfaqësim të konceptit se dhunuesit kanë bërë turp, jo viktimat, dhe se viktimat nuk duhet t'ua mbulojnë atë turp. Për të është e rëndësishme që të validohet përvoja e të mbijetuarve dhe të figurojnë emrat e dhunuesve, në mënyrë që të mbesin në histori si dëshmi.

Gjithashtu e intervistuarat konsideron se ky proces 'ua kthjellë mendjen njerëzve', dhe me realizimin e ndjekjes së drejtësisë, edhe paragjykimi ulet dhe të mbijetuarit do të mund të ecin përpara. E mbijetuarat thekson se të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë kanë nevojë për përkrahje, jo paragjykim.

Si do të mund të ndihmonin të tjerët?

E intervistuarat do dëshironte që shoqëria në përgjithësi ta mbante çështjen e viktimave të dhunimit gjatë konfliktit si 'të shenjtë' – domethënë të jenë absolutisht të mbrojtur apo paprekur nga paragjykimi, stigma, si dhe nga definimi i personalitetit të tyre me këtë ngjarje.

E intervistuarat e ka përshtypjen që të tjerët nuk e kuptojnë se sa ndikim negativ ka stigma edhe në procesin e drejtësisë. E intervistuarat thotë se kur viktimat nuk ndihen të pranuar, nuk mund të kalojnë në hapin tjetër të kërkimit të drejtësisë.

Nga familja do dëshironte që ta mirëkuptonin se jetesa si e mbijetuar e dhunimit gjatë konfliktit, në rrethanat specifike në Kosovë, e ka bërë të jetë shpesh person i zemëruar, dhe në shumë raste e ka eksternalizuar këtë zemërim tek të tjerët, duke e mbajtur traumën brenda.

Dhe në fund, nga shteti do dëshironte përkrahje mjekësore për viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit. E intervistuarat konsideron që në përgjithësi ato kanë shumë pasoja në shëndetin e tyre (jo vetëm mendor) si pasojë e ngjarjes gjatë konfliktit, dhe ndjen se pensioni që merr si viktimë e dhunës seksuale gjatë konfliktit nuk është i mjaftueshëm për nevojat shëndetësore.

Pritshmëritë në aspektin e drejtësisë

E intervistuarat është e vendosur që të kontribuojë si dhe ku të mundet, në kushte anonimiteti, në procesin e kërkimit të drejtësisë. E intervistuarat është e motivuar për këto procese sidomos kur zhvillohen në grup.

Pritshmëritë e saj janë që kryesisht do të gjinden dhe që nuk është vonë për këtë. E intervistuarat beson se e ardhmja duket më mirë për të mbijetuarit e dhunimit gjatë konfliktit në Kosovë. E intervistuarat beson se në njëfarë forme edhe të mbijetuarit e dhunës seksuale do të bëhen simbol i sakrificës së konfliktit.



ANALIZË

Qasja në drejtësi për viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit

Viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit janë përballur me sfida të jashtëzakonshme për të arritur drejtësi pas përfundimit të konfliktit. Në Kosovë, procesi i qasjes në drejtësi ka qenë i ngadaltë dhe i vështirë, i karakterizuar nga mungesa e ndëshkimeve për autorët e krimeve dhe nga barrierat institucionale dhe sociale. Në vazhdim synohet të jipet një vështrim i hollësishëm mbi këtë proces, duke përfshirë zhvillimet kryesore, sfidat e vazhdueshme dhe përpjekjet për përmirësim.

Amnesty International ka theksuar problematikën e qindra dëshmime të deponuara paraprakisht tek Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), përfshirë të krimeve të dhunës seksuale, të cilat nuk janë procesuar. Amnesty International kanë theksuar shqetësimin se provat mund të jenë humbur, dhe që neglizhimi apo stagnimi në përgjithësi i procesit gjithsesi çon në zhgënjimin e viktimave (Amnesty International, 2017).

Në vitin 2008, Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX)⁴ mori përsipër përgjegjësinë për drejtësinë dhe policinë në Kosovë. Megjithëse EULEX kishte një mandat të fortë për të ndjekur penalisht krimet e konfliktit, përfshirë krimet e dhunës seksuale gjatë konfliktit, progresi ka qenë i ngadaltë. Shumë raste të krimeve të konfliktit nuk janë ndjekur penalisht, dhe proceset gjyqësore shpesh janë zvarritur për vite me radhë.

Nga viti 2018, dëshmitë ekzistuese kanë kaluar nga EULEX-i tek Prokuroria Speciale e Republikës⁵ së Kosovës. Deri tani, shtatë aktakuza janë ngritur për dhunimin si krim lufte, ndërsa QKRMT i ka mbështetur rreth 40 raste për të dëshmuar tek ky institucion.

Prej tyre, gjashtë janë në proces ndërsa një ka përfunduar, me ç'rast Zoran Vukotić është dënuar në vitin 2021. Ai ishte dënuar fillimisht nga Gjykata Themelore në Prishtinë me 10 vite burgim, ndërsa pas kalimit të rastit në Gjykatën e Apelit, është dënuar me 13 vite burgim, vendim ky i vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme. Para këtij procesi që konkludoi me dënim, viktimat kishin kërkuar edhe herë të tjera të arrinte drejtësi. Ajo e kishte raportuar rastin edhe më parë, përfshirë në vitin 2010 tek EULEX. Sidoqoftë, iniciativat e mëparshme nuk ishin shtjelluar tutje.

Një pikë kthese dhe njëkohësisht shprehe për rastet e dhunës seksuale, sikurse edhe për krimet tjera që kanë ndodhur gjatë konfliktit, paraqet iniciativa e institucioneve kosovare për ndryshime ligjore. Në korrik të vitit 2019 ka hyrë në fuqi ligji i cili parasheh gjykimin në mungesë ndaj të pandehurve që supozohen të kenë kryer vepra penale kundër të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare dhe të Drejtës Ndërkombëtare Penale, në periudhën janar 1990 deri në qershor 1999 (Kuvendi i Kosovës, 2023).

4 <https://www.eulex-kosovo.eu/>

5 <https://prokuroria-rks.org/psrk/>

Përkundër këtyre iniciativave numri i rasteve të gjykuara për krimet e kryera gjatë konfliktit mbetet mjaft i vogël.

Njohja ligjore e viktimave të dhunës seksuale gjatë konfliktit dhe procesi i aplikimit

Pas përfundimit të konfliktit, kryesisht me iniciativën e QKRMT-së në bashkëpunim me organizatat tjera si dhe me ndihmën e partnerëve ndërkombëtarë, Kosova ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të adresuar nevojat e viktimave të dhunës seksuale. Ndër nevojat e para ishte përfshirja e këtyre viktimave në kuadrin ligjor ekzistues që rregullonte statusin e kategorive të dala nga lufta [Kuvendi i Kosovës, 2011], siç ishin invalidët apo familjet e dëshmorëve.

Pas shumë përpjekjeve, në vitin 2014, Kuvendi së Kosovës [2014] miratoi një ligj i cili mundësoi ndryshimin e ligjit ekzistues për kategoritë e dala nga lufta. Si rezultat, ligji u ndryshua në atë mënyrë që nga ajo kohë përfshin edhe viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit.



Njohja e statusit të viktimave të dhunës seksuale, ndonëse vonë, ka qenë adresim i dhimbjes së të mbijetuarve si dhe ngjarjes në vetvete. Një numër më i madh i të mbijetuarve janë lajmëruar si viktima të dhunimit vetëm pas fillimit të implementimit të ligjit, me gjasë sepse kjo mund të ketë qenë hera e parë kur deklarimi ka pasur më shumë përparësi sesa pasoja, kryesisht psikosociale. Gjithashtu, përmes penzioneve që u jipen personave që u njihet ky status, është mundësuar edhe një lloj fuqizimi ekonomik, edhe pse jo i mjaftueshëm për vetë-mbështetje në aspektin ekonomik, duke konsideruar se afërsisht 80% e viktimave janë të papunësuar/a [QKRMT, 2022].

Pas miratimit të ligjit në vitin 2014, pengesë tjetër ishte mungesa e rregulloreve përkatëse përmes të cilave do të përcaktoheshin në detaje procedurat dhe kriteret që duhet të ndiqeshin për fillimin e aplikimit për njohje të statusit si viktima të dhunës seksuale gjatë

konfliktit. Në dhjetor të vitit 2015 u miratua Rregullorja për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës [Qeveria e Kosovës, 2015] dhe më vonë Udhëzuesi për Procesin e Njohjes dhe Verifikimit të Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës [Qeveria e Kosovës, 2018]. Kështu u definua edhe mënyra e funksionimit të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Personave të Dhunuar gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës, ashtu siç udhëzonte edhe ligjislacioni i lartcekur.

Kjo zvarritja brenda institucioneve ka penguar procesin. Si rezultat i kësaj janë paraqitur vonesat e theksueshme, dhe tek në shkurt të vitit 2018, më shumë se një vit nga hyrja në fuqi e Rregullores, është bërë i mundur aplikimi nga rastet e para pranë këtij Komisioni për njohje të statusit.

Përkundër përgatitjeve të Komisionit, procesi i shqyrtimit të aplikimeve deri në marrjen e vendimit, vitet e para ka zgjatur shumë. Si pasojë, shumë personave që kanë aplikuar iu është dashur që të presin [fillimisht më shumë se një vit] derisa Komisioni iu ka kthyer përgjigje. Rast përfaqësues është edhe subjekti i këtij studimi, e cila pas gjithë asaj pritjeje ka marrë përgjigje pozitive për të, me ç'rast i është njohur statusi *viktimë e dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë*. Ajo ka filluar që si beneficion ta gëzojë edhe pensionin prej 230-euro nga skema *viktimat civile*, i rregulluar qëllimisht brenda këtij koncepti për të mbrojtur konfidencialitetin. Në këtë mënyrë, viktimat e dhunës seksuale të konfliktit janë më të mbrojtura nga rreziku i zbulimit apo asocimit me historinë e ngjarjes seksuale.

Të njëjtën përgjigje nuk e kanë pranuar disa raste, aplikacionet e të cilëve janë refuzuar nga ana e Komisionit Qeveritar me arsyetimin se ngjarjet që kanë treguar nuk kanë qenë mjaftueshëm bindëse, apo se nuk ka pasur prova që mbështesin pretendimet e tyre. Për të realizuar njohjen e statusit, këto raste është dashur që t'i drejtohen gjykatës. Rol të rëndësishëm në këtë proces ka pasur QKRMT si dhe organizatat tjera të cilat u ofrojnë ndihmë juridike falas kësaj kategorie duke i ndihmuar gjatë gjithë rrugëtimit të tyre për njohje të statusit.

Deri në qeshor të vitit 2024, Komisioni Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale, ua ka njohur statutin viktimë e dhunës seksuale gjatë konfliktit 1650 personave [Kallxo.com, 2024]. Sipas të dhënave nga QKRMT pjesa më e madhe e të mbijetuarve janë gra, përkatësisht 94% e viktimave i përkasin kësaj gjinie, dhe 15% kishin qenë të moshës minore (nën 18 vjeç) në kohën e ngjarjes [QKRMT, 2022a].

Në situatën aktuale, të mbijetuarit e dhunës seksuale kanë të drejtë të aplikojnë për status brenda një periudhe të caktuar, e cila për momentin është e përcaktuar deri në muajin maj të vitit 2025. Ky kufizim në kohë paraqet një pengesë të theksuar, për shkak që vendimi i të mbijetuarve për t'u njohur si viktimat e dhunës seksuale varet nga shumë faktorë. Shpeshherë familjarët nuk e dinë për ngjarjen apo nuk i përkrahin viktimat, në raste tjera të mbijetuarit nuk kanë informacione të mjaftueshme, si dhe ka raste të shumta kur të mbijetuarit ndjejnë se nëse i kthehen detajisht asaj që kanë ndodhur do të kenë përkeqësim në mirëqenien dhe/apo jetën e tyre për shkak të traumës, në pjesën më të madhe të patrajtuar.

KONKLUZIONET

Reflektimi mbi përpjekjet për drejtësi për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë konfliktit në Kosovë vë në pah se arritja e llogaridhënies mbetet një sfidë komplekse dhe e vazhdueshme. Së pari, dallimi mes numrit të viktimave dhe personave të dënuar është një indikator i mungesës së drejtësisë në vetvete.

Ky rast studimor thekson nevojën kritike për përpjekje të vazhdueshme për të adresuar padrejtësitë që u janë bërë këtyre të mbijetuarve dhe për të forcuar mekanizmat për mbrojtjen dhe përkrahjen e tyre.

Në situatën aktuale, kufizimi i kohës për njohje të statusit si viktimë e dhunës seksuale është kundërproduktiv. E intervistuar në studimin e këtij rasti është lajmëruar 18 vjet pas konfliktit, gjë që është indikator mbështetës për këtë argument. Mund të ketë të mbijetuar tjerë të cilët lajmërohen edhe vite apo dekada më vonë. Këto raste nuk janë të panjohura edhe nga kontekstet e konflikteve tjera, si për shembull në Bosnjë e Hercegovinë [Stiglmayer, 1994].

Analizat nga literatura identifikojnë disa faktorë që i kontribuojnë lajmërimin të vonuar të dhunës seksuale nga mjediset e konfliktit, si për shembull stigma, frika nga shpagimi/hakmarrja, dhe mungesa e besimit në sistemet e drejtësisë dhe ato mbështetëse [Kovats, 2019]. Në studimin aktual, këta faktorë janë shumë evidentë. Në lidhje me stigmën, për shembull, e intervistuar ka hezitur të lajmërohet sepse ka menduar se emri i saj do publikohet diku. Sa i përket kësaj pike, strategjia e ruajtjes së konfidencialitetit përmes skemës viktimë civile, është qasje e përshtatshme për ta adresuar këtë problem. Gjithashtu, aplikimi për njohje të statusit përmes procedurave konfidenciale si dhe me ndërmjetësimin e palëve të treta [OJQ-ve] është qasje lehtësuese dhe praktike.

Në anën pozitive të zhvillimeve mund të theksohet miratimi i ligjit që garanton mundësinë edhe për pension. Kjo lloj mbështetjeje është thelbësore për të përmirësuar cilësinë e jetës së të mbijetuarve. Përmes këtij ligji, institucionet e Kosovës jo vetëm që kanë adresuar pasojat e dhunës seksuale, por gjithashtu ofrojnë një platformë për të përparuar drejt drejtësisë dhe për të ndihmuar në rikuperimin e jetës së të mbijetuarve, duke nxitur një kulturë më të fortë të përkrahjes dhe solidaritetit.

Në anën tjetër, zvarritja dhe apo/mosbërja sa duhet për drejtësi dhe llogaridhënie, qartazi ka ndikuar në besimin e të intervistuarës në sistemet e drejtësisë. Kjo reflektohet në narracionin e saj mbi ndjenjat që i ka pasur gjatë viteve kur tema e dhunës seksuale si pasojë e konfliktit nuk është diskutuar në ambiente institucionale. Ky zhgënjim mund të përgjithësohet edhe në aspekt kolektiv (për viktimat tjera), duke konsideruar numrin e vogël të aktakuzave të ngritura gjer tani, 25 vjet pas konfliktit.

Një përfundim tjetër që del nga rasti studimor është rëndësia e punës së sistemeve mbështetëse për viktimat e dhunës seksuale gjatë konfliktit, për t'i përkrahur ato në aspektin psikosocial. Fakti që vetëm pasi e mbijetuara ka shkuar në QKRMT ka mundur të flasë me burrin dhe të ndajë atë që ka ndodhur, e thekson rëndësinë e fuqizimit nga organizatat që kanë ekspertizën dhe përvojën e mjaftueshme për të punuar me të gjitha nuancat e situatave të mbijetuara.


Për më tutje, e intervistuar paraqet rast tipik kur simptoma klinike të stresit post-traumatik janë shfaqur dhe kanë afektuar në masë të madhe jetën e saj pas ngjarjes traumatike. Këtu përfshihen ndjenjat e saj të mungesës së vullnetit, vështirësia në rregullimin e emocioneve, ndjenjat e izolimit si dhe pikëpamjet negative mbi botën, që përkojnë me kriteret diagnostikuese (American Psychiatric Association, 2013). Prandaj ndihma psikosociale që e intervistuar e ka marrë nga organizatat mbështetëse, është esenciale për mirëqenien e saj.

Në veçanti këtu mund të theksohet elementi grupor i ndihmës. E intervistuar raporton që është ndjerë shumë më mirë pas takimeve grupore me të mbijetuara të tjera të dhunës seksuale gjatë konfliktit. Kjo për shkak se ndarja e përvojave në grup mundëson njohjen e tyre (Ellsberg & Heise, 2015), dhe rrjedhimisht ka ndikim në përmirësimin e shëndetit mendor. Në Kosovë, dobia e mbështetjes grupore ka edhe përparësinë e uljes së fuqisë së stigmës.

E intervistuar ka theksuar si pikë kthese edhe daljen publike të mbijetuarave tjera si avokuese për të drejtat e tyre. Në veçanti ajo ka theksuar shoqërimin e presidentes nga të mbijetuarat në një mbledhje të Këshillit të Sigurimit të OKB. Ky është një element rikujtues që kur institucionet e pranojnë dhe adresojnë publikisht dhunën seksuale gjatë konfliktit, luajnë rol të rëndësishëm në validimin e përvojave të mbijetuarave. Është me rëndësi të theksohet se kjo njohje nuk është vetëm simbolike, por u ofron mbijetuesve një ndjenjë legjitimiteti që është thelbësore për procesin e tyre të shërimit. Kur diskutohen dhe adresohen hapur këto çështje, institucionet kontribuojnë në reduktimin e stigmatizimit dhe krijimin e një ambienti ku të mbijetuarit ndihen të mbështetur dhe të besuar, gjë që është kritike për riintegrimin e tyre në shoqëri.

Nëse fokusohemi në ndërlidhjen e ngushtë mes stigmës dhe lajmërimit të vonuar të dhunimit si krim, atëherë mund të theksojmë se bisedat në nivel institucional për dhunën seksuale gjatë konfliktit ndikojnë indirekt që t'u hapin rrugë viktimave që të dalin dhe të kërkojnë drejtësi, pasi që stigma ulet.

Përveç faktorëve të diskutuar më lart, është gjithashtu e rëndësishme të shqyrtohen dinamikat komplekse që dalin nga marrëdhëniet personale dhe ndikimi i tyre në ndjekjen e drejtësisë. Në rastin studimor aktual, e mbijetuara do ishte e gatshme të raportojë rastin në polici, por përballet me kundërshtim nga bashkëshorti. Kjo thekson, edhe një herë, sfidat shumëdimensionale me të cilat përballet të mbijetuarit e dhunës seksuale. Mungesa e mbështetjes nga bashkëshorti mund të përkeqësojë ndjenjat e izolimit dhe të zvogëlojë mundësitë e të intervistuarës për të kërkuar riparacion dhe drejtësi.



REKOMANDIME

Duke u bazuar në seksionet e mësipërme dhe më specifiku në konkluzione, studimi aktual nxjerr disa rekomandime, siç detajohet më poshtë.

Në lidhje me ndikimin e marrëdhënieve personale në ndjekjen e drejtësisë, rekomandojmë që: akterët relevantë të kenë qasje gjithëpërfshirëse që përfshin jo vetëm ndihmën ligjore, por gjithashtu mbështetje për të mbijetuarit në përballimin e pengesave personale. Sigurimi i burimeve që adresojnë si nevojat ligjore ashtu edhe ato emocionale është thelbësor për të fuqizuar të mbijetuarit në ndjekjen e drejtësisë dhe në rindërtimin e jetës së tyre.

Duke u ndërlidhur me efektin e përkrahjes institucionale tek e intervistuarat e rastit studimor, rekomandojmë që procesi i drejtësisë penale të ketë më shumë aktivitete mbështetëse dhe sensibilizuese nga ana institucionale për t'i inkurajuar të mbijetuarit edhe për inicim të procesit ligjor.

Sa i përket pengesës së afatit të kufizuar për aplikim për njohje të statusit viktimë e dhunës seksuale gjatë konfliktit, rekomandojmë që ky afat kohor të mos kufizohet. Ka shumë faktorë që ndikojnë zbulimin nga ana e të mbijetuarve se kanë përjetuar dhunë

seksuale gjatë konfliktit, qoftë edhe tek organizatat e besueshme. Andaj duhet marrë parasysh këta faktorë dhe ndikimin e tyre tek të mbijetuarit, që mund të mos jenë gati deri më vonë për t'u lajmëruar dhe përfituar nga ky ligj. Praktika të tilla kanë ndjekur Kroacia dhe Bosnja e Hercegoviva, që mund të jenë shembuj për t'u shqyrtuar.

Në anën tjetër, rekomandojmë që Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve e Kosovës të mundësojë dy zgjidhje shtesë që do t'i përkrahnin të mbijetuarit edhe më shumë: a) të mundësojë me ligj penzionet e dyfishta apriori [i.e. pensionin e moshës dhe kontributdhënës dhe atë të viktimës së dhunës seksuale nga lufta], në mënyrë që të shmangen procedurat e lodhshme gjyqësore për përfituesit e tyre; b) kartelat e beneficioneve që i përdorin përfituesit e statusit të kategorive të dala nga lufta të mos jenë specifike për kategori [p.sh. invalid, apo viktimë e dhunës seksuale], por kartela të jetë e përbashkët dhe jodalluese për të gjitha kategoritë. Kësisoj, të mbijetuarve do ju mbrohej identifikimi si viktimë e dhunës seksuale gjatë konfliktit, duke ju dhënë më shumë mbrojtje psikosociale.

Dhe në fund, rekomandojmë trajnime për profesionistët relevantë në spektrin e drejtësisë në mënyrë që të zvogëlohet stigma dhe rastet të trajtohen efektivisht dhe me ndjeshmëri ndaj temës. Kjo do ju ndihmonte profesionistëve të mbështesnin të mbijetuarit edhe nga një qasje e informuar mbi traumën.

Si përfundim, ky studim rasti nënvizon nevojën për mekanizma gjithëpërfshirës të drejtësisë për të adresuar dhunën seksuale gjatë konfliktit në Kosovë, duke rritur zërat e të mbijetuarve që kërkojnë llogaridhënie dhe shërim. Perspektiva e dhënë nga e intervistuarat si subjekt i këtij studimi nxjerr në pah se sa e rëndësishme është për praktika dhe politika qasja e cila në qendër ka të mbijetuarit. Është e nevojshme që këto rekomandime të zbatohen për të siguruar një të ardhme ku drejtësia dhe mbështetja për të mbijetuarit janë prioritare.

REFERENCAT

American Psychiatric Association. Diagnostic and statistical manual of mental disorders. 5th ed. Arlington, VA: American Psychiatric Association; 2013.

Amnesty International. [2017]. "Plagë që të djegin shpirtin".
<file:///C:/Users/Guest1/Downloads/EUR7075582017ALBANIAN.pdf>

BBC News. [2023, September 20]. Kosovo president brings sexual violence survivors to UN Security Council. BBC News.
<https://www.bbc.com/news/world-europe-66853822>

Bumiller, E. [1999, 22 qershor]. Kosovo Victims Must Choose to Deny Rape or Be Hated. *The New York Times*.
[Crimes: Kosovo Victims Must Choose to Deny Rape or Be Hated \[nytimes.com\]](https://www.nytimes.com/1999/09/22/world/europe/kosovo-victims-must-choose-to-deny-rape-or-be-hated.html)

Danjibo, N. & Akinkuotu, A. [2019]. Rape as a weapon of war against women and girls. *Gender and Behaviour*, 17[2].
[Rape as a weapon of war against women and girls | Gender and Behaviour \[journals.co.za\]](https://www.journals.co.za/doi/10.1080/15257546.2019.1644444)

Diken, B., & Laustsen, C. B. [2005a]. Becoming abject: Rape as a weapon of war. *Body & Society*, 11[1], 111–128.
<https://doi.org/10.1177/1357034x05049853>

Ellsberg, M., & Heise, L. [2005]. *Researching violence against women: A practical guide for researchers and activists*. World Health Organization.
<https://www.who.int/reproductivehealth/publications/violence/9241546476/en/>

Hjort, L., Rushiti, F., Wang, S.-J., Fransquet, P., Krasniqi, S., I Çarkaxhiu, S., Arifaj, D., Xhemaili, V. D., Salihu, M., A Leku, N., & Ryan, J. [2021]. Intergenerational effects of maternal post-traumatic stress disorder on offspring epigenetic patterns and cortisol levels. *Epigenomics*, 13[12], 967–980.
<https://doi.org/10.2217/epi-2021-0015>

Human Rights Watch. [2000]. *Kosovo: Rape as a Weapon of "Ethnic Cleansing"*.
<https://www.refworld.org/reference/countryrep/hrw/2000/en/17379>

Kallxo.com [2024, 1 gusht]. *2 mijë e 83 aplikime për statusin e viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës*.
<https://kallxo.com/lajm/2-mije-e-83-aplikime-per-statusin-e-viktimes-se-dhunes-seksuale-gjate-luftes/>

Kovats, S. [2019]. Delayed disclosure of sexual violence in conflict settings: Evidence and implications. *International Journal of Conflict and Violence*, 13[1], 1–14.
<https://doi.org/10.4119/ijcv-2858>

Kuvendi i Kosovës. [2011, 31 dhjetor]. Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2793>

Kuvendi i Kosovës. [2014, 23 prill]. Ligji Nr. 04/L-172 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave të dhunës seksuale të luftës, viktimave civile dhe familjarëve të tyre. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9436>

Kuvendi i Kosovës. [2023, 23 nëntor]. Ligji Nr. 08/L-187 për plotësimin dhe ndryshimin e Kodit Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=84233>

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës. [2021]. *E drejta për të vërtetën “Viktimat pa emër”*. Prishtinë: QKRMT.

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës [QKRMT]. [2022]. *“Dokumentimi i dhunës seksuale në Kosovë gjatë luftës 1998-1999”: Pjesa A*. Marrë më 05.09.2024 nga

<https://krct.org/dokumentimi/pjesa-a/#1658171742917-53c40e16-7bb8>

Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës [QKRMT]. [2022a]. *“Dokumentimi i dhunës seksuale në Kosovë gjatë luftës 1998-1999”: Pjesa B*. Marrë më 05.09.2024 nga

<https://krct.org/dokumentimi/pjesa-b/>

Qeveria e Kosovës. [2015]. “Rregullore [Qrk] Nr. 22/2015 për Përcaktimin e Procedurave për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë Luftës Çlirimtare të Kosovës”. Marrë nga

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15057>

Qeveria e Kosovës. [2018]. *“Udhëzues për procesin e njohjes dhe verifikimit të statusit të personave të dhunuar gjatë luftës çlirimtare të Kosovës”*. Marrë nga

<https://mpms.rks-gov.net/en/wpdm-package/udhezues-per-procesin-e-njohjes-dhe-verifikimit-te-statusit-te-personave-te-dhunuar-gjate-luftes-clirimtare-te-kosoves-pdf/?wpdmdl=4850>

Stiglmayer, A. [Ed.]. [1994]. *Mass rape: The war against women in Bosnia-Herzegovina*. University of Nebraska Press.

Mbështetur / Supported / Podržana:



**Funded by
the European Union**



Funded by
the European Union



QKRMT-KRCT

Qendra Kosovare për Rehabilitimin
e të Mbijetuarve të Torturës
The Kosova Rehabilitation
Center for Torture Victims



**PATHS TO JUSTICE:
THE PERSPECTIVE OF A SURVIVOR AND
EFFORTS TO ADDRESS SEXUAL VIOLENCE
DURING THE CONFLICT IN KOSOVO**

- Case Study -

Authors: KRCT

